

VENDIM
Nr. 948, datë 26.12.2012

**PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE PËR
VAZHDIMIN/KRYERJEN/PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT, ME
OBJEKT “FURNIZIMIN ME UJË I PLAZHEVE DURRËS-KAVAJË NGA PUSHPIMET E
ÇERMËS, LOTI II (LINJAT ME PRESION NGA RROGOZHINA, PIK 426, DERI TE
PUSNDËRPRERJE KAVAJË, LINJA PUSNDËRPRERJE DERI NË DEPON EKZISTUESE
KAVAJË)”, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve për vazhdimin/kryerjen/përfundimin e procedurave të prokurimit, me objekt “Furnizimi me ujë i plazheve Durrës-Kavajë, nga pusshpimet e Çermës, loti II (linjat me presion nga Rrogozhina, PIK 426, deri te pusndërprerje Kavajë, linja pusndërprerje deri në depon ekzistuese Kavajë)”, si autoritet kontraktor.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha